



KONTRATË PËR ANËTARËSIM TË PUNËMARRËSIT NË NJË PLAN PENSIONI PROFESIONAL TË KRIJUAR NGA PUNËDHËNËSI NË FONDIN E PENSIONIT VULLNETAR ALBSIG

Kontratë e lidhur sot, më datë ____/____/20____, në Tiranë nga dhe ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

ALBSIG INVEST SHA - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, me NUIS/NIPT L92208025J, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HQ,1001, Tiranë, Shqipëri, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Vendimin nr. 210, datë 22/11/2019, përfaqësuar nga z. Elton Korbi, Administrator i Përgjithshëm, me nr. dokumenti identifikimi I30919045R (këtu e më poshtë “Shoqëria Administruese”).

dhe;

TË DHËNAT E ANËTARIT TË FONDIT TË PENSIONIT VULLNETARË ALBSIG:

Emër Atësia Mbiemër: _____ Nr. dokumentit të identifikimit: _____
(kopje bashkëlidhur), Adresë: _____, Datë lindja: _____
____/____/____, Vendlindja: _____, Shtetësia: _____, Tel./Mob: _____
E-mail: _____, Shuma e kontributit mujor: _____ (lekë), Mënyra e pagesës: _____
_____, Burimi i të ardhurave: _____.

TË DHËNAT E SHOQËRISË PUNËDHËNËSE:

_____, i regjistruar me NUIS/NIPT _____, me seli në adresën _____, përfaqësuar nga Z./Znj. _____, Administrator, me nr. dokumenti identifikimi _____ (këtu e më poshtë “Punëdhënësi”).
Shuma e kontributit mujor: _____ (lekë), Mënyra e pagesës: _____, Burimi i të ardhurave _____.

ANËTARI:

Shoqëria PUNËDHËNËSE
përfaqësuar nga:

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm:

(Emër, Mbiemër, Firmë)

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë nëse ka)

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë)





NENI 1 - OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

- Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis Anëtarit të Fondit ("Anëtari") dhe Shoqërisë Administruese, që rrjedhin nga anëtarësimi i tij në Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig ("Fondi"), nëpërmjet skemës profesionale të krijuar nga Punëdhënësi i tij, me qëllim investimin e aseteve dhe ofrimin e përfitimeve për pension.
- Kjo kontratë mbështetet në nenet 4, pikat d) dhe r) dhe 6 të ligjit nr.10197/2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" ("Ligji"), rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr.2/2011 "Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit", si dhe prospektin e aktet e tjera të brendshme të Shoqërisë Administruese.

NENI 2 - ANËTARËSIMI

- Çdo person mund të anëtarësohet në Fond duke lidhur një kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese.
- Anëtari duke nënshkruar kontratën konfirmon se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese.
- Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale për çdo Anëtar, sipas kontratës së lidhur.

NENI 3 - PAGESA E KONTRIBUTEVE

- Shuma e kontributit përcaktohet nga çdo anëtar, por jo më pak se 1,000 (njëmijë) lekë në muaj.
- Kontributet do të derdhen në numrin e llogarinë së Fondit IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100, pranë Bankës Tirana Sh.a, e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit në përputhje me përcaktimet e ligjit.
- Anëtari zgjedh frekuencën e pagesës së kontributeve e cila mund të jetë mujore, me një periodicitet tjetër ose si një shumë totale. Pavarësisht nga frekuenca e pagesës së kontributeve e zgjedhur nga Anëtari, në çdo rast shuma do të jetë në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
- Kontributet e kryera nga Punëdhënësi në favor të Punëmarrësit konsiderohen si kontribute të paguara nga vetë Punëmarrësi.
- Në Anëtarit në Fond përbëhen kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit, dhe nga kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme, sipas dispozitave ligjore dhe kontratës.
- Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni, sipas çmimit të kuotës një ditë para pagesës së kontributit, kontributet e investuara në Fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilin nga asetet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të Fondit.
- Procedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga Anëtari në kuota përcaktohet në Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Në Anëtarit ndërpret pagesën e kontributeve, ai mbetet anëtar në Fond me të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të Fondit.
- Në Anëtarit kërkohet të ndryshojë shumën e kontributit apo të pezullojë kontributet, ai mjafton të dërgoj një njoftim me shkrim pranë Shoqërisë Administruese dhe këto ndryshime do kryen në mënyrë automatike.
- Punëdhënësi është përgjegjës ndaj Punëmarrësve të vet për mospagimin e ndonjë kontributit të parashikuar së bashku me interesin e mos fituar dhe kosto të tjera të hasura nga Punëmarrësi i pasojë e mospagimit të kontributeve.

NENI 4 - POLITIKA E INVESTIMIT

- Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi.
- Portofoli i Fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë (letra me vlerë me maturim më të lartë se një vit) të emetuar dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- Karakteristikat e politikës së investimit paraqiten në Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese, bashkëngjitur kësaj kontrate.
- Anëtari pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin, merr përsipër rrezikun e investimit të Fondit. Kuotat në Fond nuk janë të garantuara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

NENI 5 - DEPOZITARI

- Shoqëria Administruese ka lidhur kontratë me Bankën Tirana Sh.a, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT J61924008V, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", e cila sipas ligjit do të jetë Depozitari për asetet e Fondit.
- Depozitari në bazë të Vendimit Nr.23, datë 24.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me vendimin Nr.2, datë 06.06.2019.
- Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve në Fond. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit si dhe të legjislacionit në fuqi.
- Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese, dhe çdo palë tjetër të lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e Fondit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

NENI 6 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

- Shoqëria Administruese merr përsipër:
- Të administrojë me efektivitet asetet e anëtarëve në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e aseteve të anëtarëve;
 - Të ofrojë pensione dhe përfitime të tjera tek anëtarët, sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
 - Të informojë çdo anëtar lidhur me prospektin e Shoqërisë Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën;
 - Të paktën çdo 30 (tridhjetë) ditë, duhet të informojë çdo Anëtar për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aseteve të Anëtarit në Fond, datat e kontributeve dhe transferimit e aseteve të bëra nga ose në emër të Anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aseteve në kuota pensioni, në mënyrë elektronike;
 - Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo Anëtarit, dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek Anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtari, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji;
 - Të informojë në çdo kohë Anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikën e investimit, si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për Anëtarët.
 - Të kryejë transferimin e aseteve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të administruar nga një tjetër Shoqëri Administruese.

NENI 7 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

- Anëtari ka të drejtat e detyrimit e mëposhtme:
- Të lexojë me vëmendje Prospektin e Fondit;
 - Të ketë në çdo kohë pronësinë e aseteve të investuara në Fond;
 - Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
 - Të informohet në periudha të rregullta kohore, dhe të paktën çdo 30 (tridhjetë) ditë, mbi vlerën neto të aseteve në llogarinë e tij të pensionit;
 - Anëtarit i lind e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga Punëdhënësi jo përpara 2 (dy) viteve mbas kontributit të parë të kryer nga Punëdhënësi;

- Nëse Punëmarrësi ndërpret marrëdhënien e punës me Punëdhënësin ai mbetet anëtar i fondit, dhe nëse kërkohet të vazhdojë të kontribuojë në Fond në mënyrë individuale duhet të rridh një kontratë individuale me Shoqërinë Administruese;
 - Të pajiset me dokumentin që vërteton pagesën e kontributeve në llogarinë e tij;
 - Të transferojë asetet e akumuluar në një Fond tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër Shoqëri Administruese. Në rastin e transferimit të aseteve, Anëtari përfundon kontratën e mëparshme si dhe lidh një kontratë anëtarësimi në Fondin tjetër të pensioneve vullnetare;
 - Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm.
- Gjithashtu Anëtari merr përsipër:
- Të përcaktojë shumën e kontributeve që do të paguajë, të ndryshojë këtë shumë si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
 - Të paguajë në mënyrë të rregullt kontributet në shumën dhe kohën e përcaktuar në kontratë;
 - Të informojë menjëherë dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë Shoqërinë Administruese lidhur me ndryshimet e kushteve që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Fond;
 - Të informojë Shoqërinë Administruese për çdo ndryshim në të dhënat personale.

NENI 8 - TRANSFERIMI I ASETVE

- Anëtari ka të drejtë që, në çdo kohë, të transferojë asetet e veta nga një Fond në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër Shoqëri Administruese.
- Nëse anëtari në një Fond, Fond i mëparshëm i pensionit, vendos të bashkohet me një tjetër Fond pensioni, Fondi i ri i pensionit, ai duhet të njoftojë Shoqërinë Administruese që administron fondin e mëparshëm të pensionit, që ai ka vendosur të transferojë asetet e veta në një tjetër fond pensioni të administruar nga e njëjta ose nga një tjetër Shoqëri Administruese dhe që shuma në llogarinë e tij, pasi të jenë bërë zbritjet përkatëse, në përputhje me kontratën e fondit të pensionit, duhet të transferohet në fondin e ri të pensionit.
- Transferimi i aseteve në fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas 10 (dhjetë) ditësh pune, pasi Shoqëria Administruese e Fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga Anëtari.

NENI 9 - PAGESA E PËRFITIMEVE

- Anëtari i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlerë:
 - 1.5 (pesë) vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar me Ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë Anëtar;
 - 1.2. kur bëhet i paafte për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 2. Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e kërkesës;
 3. Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë, e lidhur midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfutur.
- Me qëllim përfitimit e pagesës së të gjithë aseteve të veta në Fond, Anëtari i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, i cili përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.

NENI 10 - TËRHEQJA E PARAKOHSHME

- Anëtari ka të drejtë që të tërheqë asetet nga llogaria individuale e Fondit përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 9 të kontratës. Shoqëria Administruese kryen pagesën e vlerës neto të aseteve në llogarinë e Anëtarit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit për tërheqje të parakohshme.
- Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitetin të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve, dhe më konkretisht:
 - 2.1. 2% (dy përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
 - 2.2. 5% (pesë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - 2.3. 10% (dhjetë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - 2.4. 15% (pesëmbëdhjetë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
- Në rastin e vdekjes së Anëtarit penaliteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

NENI 11 - PAGESA E ASETVE NË RASTIN E VDEKJES SË ANËTARIT

Në rastin kur Anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

NENI 12 - TARIKAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

- Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifën e mëposhtme:
 - 1.1. Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit.
 - 1.2. Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aseteve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj.
 - 1.3. Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhur nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar.
- Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve në Fond të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

NENI 13 - KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasojë ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.
- Kontrata përfundon:
 - 2.1. Kur të gjitha asetet e Anëtarit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
 - 2.2. Në rastin e tërheqjes së parakohshme;
 - 2.3. Në rastin e vdekjes së Anëtarit.

NENI 14 - ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE E MOSMARRËVESHJEVE

- Pala që do të zgjidhë kontratën duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 3 (tre) muaj nga data e zgjidhjes së kontratës.
- Çdo mosmarrëveshje mes palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

NENI 15 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptim të palëve si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në të gjitha rastet që kërkohet nga Ligji.
- Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në numër kopje origjinale, nga një për secilin palë, përfshirë edhe personin e tretë që paguan kontributet për Anëtarin e Fondit.
- Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Nën cilësinë e Anëtarit të Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam kuptuar dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, prospektin si dhe tarifën e aplikuar nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig.

